



RELACION ARKITEKTONIK DHE SPECIFIKIME TEKNIKE RIKOSTRUKSIONI I NYJEVE H-SANITARE TE KONVIKTIT TE SHKOLLES SE FISKULTURES “BERNARDINA QERRAXHIA”

Konvikti i Shkolles se fiskultures “Bernardina Qerraxhia” ndodhet ne rrugen “Mujo Ulqinaku” ne nje godine 4 kate e ndertuar para shume vitesh. Gjendja e ambjenteve ne knvikt eshte jo e mire, si dhe duket nga fotot e meposhteme. Per arsye te mungeses se fondeve do te behet nje here rikonstruksioni nyjeve higjeno-sanitare dhe me vone do te shihet mundesia e rikonstruksionit total te godines.




Foto te ambjenteve te konviktit.





BASHKIA DURRES
DREJTORIA E SHEBIMEVE PUBLIKE
NJESIA E PROJEKTIT DHE INFRASTRUKTURES



Rikonstruksioni parashikon rikonstruksionin e ambjenteve te nyjeve h-sanitare te kateve te pare dhe te dyte. (kati i trete i konviktit nuk eshte ne funksion).

Ne cdo kate ka nje ambjent per WC dhe nje ambjent per dushe si per vajza dhe per djem me siperfaqje 13 m² per ambjent. Ambjenti i dusheve dhe WC jane te ndricuara ne menyre te drejteperdrejt.

Rikonstruksioni i ketyre ambjenteve perfshin punime shtresash, veshje muresh me pllaka, vendosja e paisjeve te reja hidrosanitare, realizimi i shkakimeve te reja, furnizimi me uje, dhe punimet elektrike.

LLAÇI

Llaç bastard marka 15 me rërë natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me, çimento: gelqere: rërë ne raPortë 1: 0,8: 8. Gelqere e shuar lt 110 , çimento 300 kg 150 , rërë m³ 1,29 .

Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40%) e formuar me, çimento: gelqere: rërë ne raPortë 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 92 , çimento 300 kg 212 , rërë m³ 1,22 .

Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gelqere, rërë ne raPortë 1: 0,8: 8. Gelqere e shuar lt 105 , çimento 300 kg 144 , rërë m³ 1,03 .

Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35 %) e formuar me , çimento: gelqere, rërë ne raPortë 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 87 , çimento 300 kg 206 , rërë m³ 1,01 .

Llaç bastard marka 1:2 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento, rërë ne raPortë 1:2. Çimento 400 kg 527 , rërë m³ 0,89.

PUNIME DYSHEMEJE

Shtresë betoni

Shtresë betoni m-150, sipas pikes 3.a.1, me lartësi te ndryshueshme sipas udhezimeve ne projekt, i hedhur në vepër mbi nje Shtresë zhavori dhe i formuar nga shtresa te vibruara mire, duke perfshire çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre te rregullt.

Hidro - izolim i dysHEMEVE

Shtresë hidro-izolimi per te gjitha dyshemete e katit perdhe si dhe të banjove, e perberë nga 2 shtresa mapei.

DysHEME me pllaka gres

Pllakat do te jene gres porcelanato. Ngjyra e tyre do te percaktohet nga supervizori. Pllakat do te jene «zgjedhje e pare» te verifikuara ne amballazhim. Pllakat do te shrohen me kolle, mbi nje siperfaqe grezo me llaç çimento pasi te jete verifikuar nivelimi i saj me nje proces verbal. Nivelimi te behet nga nje specialist topograf me nje tolerance jo me shume se 5mm ne te gjithe godinen.

Punime suvatimi dhe veshje

Suvatim i brendshëm

Sprucim i mureve dhe tavaneve, me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e siperfaqeve te muraturës, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.



BASHKIA DURRES
DREJTORIA E SHEBIMEVE PUBLIKE
NJESIA E PROJEKTIT DHE INFRASTRUKTURES

Suvatim i realizuar nga nje Shtresë me trashesi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim per m2 : rërë e lare m3 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m3 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje te drejtuesve ne mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte. te mire te dritareve.

Punime bojatisje

5.a Bojatisje me gelqere dhe bojra plastike, hidromate ose akrilike

Lemim i suvasë se re me pare me leter zmerile nr.40 ose nr.60 dhe me pas stukim me stuko sintetike ne pjeset ku ka nevojë per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.

Me pas pasi pastrohet nga pluhuri i behet astarimi me astare te gatshem me baze akrilike ose plastike sipas tipit te bojes qe do te perdoret ,ose ne raste te vecanta pergatitet nje dore solucion lidhes e formuar me rreshire te holle me 50 % uje dhe e zbatuar me penel ose rulon mbi mure dhe tavane. Ne rastin e lyrjes me gelqere nuk aplikohet

Bojatisje ne dy duar me boje ne nje distance kohe te nevojshme per tharje te dores se pare. Siperfaqja te jete uniforme dhe pa njolla. Ne rastin e lyrjes me gelqere veprohet si me poshte :bojatisje ne tre duar, me qumesht gelqereje dhe ngjyra te ndryshme per mure te brendeshem, te jashtëm dhe tavane dhe me dozature per m2: gelqere e shuar kg 0.55, pluhur ngjyre kg 0.01 si dhe çdo gje te nevojshme per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

Punime të ndryshme

Pragje dritarësh me mermer t=3cm

Pragje me mermet me trashesi t=3 cm, me pike kullimi uji,

Specifikime teknike per objektin Rikonstruksion I banjove te shkolles Fiskultures

Tela dhe kablllo

Të gjitha telat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e fabrikës.

Telat duhet të jenë përçues të thjeshtë bakri të izoluar (veshura) me shtresë teke PVC për t'u futur brenda tubave dhe linjave.

Izolimi i telave dhe këllëfi duhet të jenë me izolim të ngjyrosur për të identifikuar fazën dhe nulin.

Telat duhet të jenë të ngjyrosura për identifikim. E zeza duhet të përdoret për përçuesit FAZËS, Jeshilja / e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra blu për përçuesit NEUTRIT. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtët përçues fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Te gjitha kabllot duhet te jene rezistente ndaj zjarrit.

Numri i kablllove që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kablllove dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ në Shqipëri.

Asnjë kabëll me seksion më të vogël se 1.5 - 2.5 mm² s' duhet të përdoret me instalim vetëm nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

1) Kanalet dhe aksesoret

Instalime elektrike do te jene

- Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
- Aksesoret e instalimeve nën suva janë :
- Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe



BASHKIA DURRES
DREJTORIA E SHEBIMEVE PUBLIKE
NJESIA E PROJEKTIT DHE INFRASTRUKTURES

të numrit të telave që do të futen në të
Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelësave
Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.
2) Llampat dhe ndriçuesit

Pozicioni i ndriçuesve duhet të jetë si ai i treguar në projekt skicën e Inxhinierit Elektrik. Instalimi i ndriçimit do kryhet duke përdorur kabllot e izolimit PVC, tipi NYN, që kalojnë brenda tubit fleksibël PVC, në përgjithësi të fshehura brenda suvasë së ndërtesës ose në kanaleta kur përdoret sistemi i kanalëve.

3) Llampat



TAVANORET Tipi : Ndricues tavani rrethor

Tipi : Ndricues tavani

Fuqia : 15W

Lloji i llambave : LED

Lloji i ndriçimit : I ftohtë

Tensioni : 220-240V

Përfshin llambat : Po

Reostat : Jo

Te gjithë llampat do te kene ngjyre te njejte.

Prizat

Priza do te kete per lidhjen e bolierave ne cdo banjo.

Gjithë prizat, derisa të bëhet një tjetër specifikim, duhet të jenë të tipit 20 amper 2-pin dhe të dala në sipërfaqe. Ato duhet të kenë montim rafsh duhet të kenë një ngjyrë që të shkojë me paftat e çelësave të ndriçimit.

Gjithë prizat duhet të jenë një tip i ngjashëm i specifikuar si më poshtë:

me ndarës sigurie 250v, 2P-20A. dhe do te jene priza universale me tokezim.

Ne fund instaluesi duhet te leshoje protokollin e tokezimit ne te cilen vertetohet qe keto prize jane Brenda KTZ. Dhe e firmosur nga ing, elektrik I firmes zbatuese.

Grupi i projektimit.

Ark. Adnand Tocila

Ark. Hysen Çifliku

Ing. Diana Dedja

Ing.Elek. Mirela Stefani